



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Ekstrakt

i procesverbalit nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 27 qershor 2018

Takimi filloi në orën 10.30

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veli, Kryetar i Komunës. Në takim ishte i pranishëm një numër i konsideruar i qytetarëve (64pjesëmarrës), përfaqësues të OJQ-ve, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësuesit e OSBE-së, dhe përfaqësues të mediave.

Tema:

- **Ecuria e realizimit të projekteve dhe të aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2018 (Gjashtëmujori i parë)**

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Qytetarë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë takim.

Në bazë të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe të Statutit të Komunës kam ftuar këtë takim për t'ju informuar lidhur me ecurinë e realizimit të projekteve dhe të aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2018, me theks të veçantë për gjashtëmujorin e parë.

Komuna për këtë vit buxhetor ka planifikuar investime në projekte të ndryshme, në bazë të buxhetit të miratuar në Kuvend.

Buxheti i Komunës për këtë vit është 20,953,255 euro, prej të cilave për investime kapitale janë 6,489,514 euro. Ndërsa për subvencione kemi një buxhet prej 568,883 euro.

Në kuadër të mjeteve që kemi në dispozicion është bërë edhe planifikimi dhe miratimi i projekteve për këtë vit kalendarik.

Sa për informimin tuaj projektet e miratuara në Kuvend, që janë të përfshira në buxhetin e Komunës, deri më tani janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik.

Edhe në këtë vit investimet kapitale kanë qenë të orientuara në projekte të ndërtimit dhe rregullimit të infrastrukturës, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës sonë.

Tashmë kemi hyrë në fazën e finalizimit të ndërtimit të infrastrukturës rrugore. Kemi të asfaltuara mbi 80 % të rrugëve nga rreth 1300 rrugë publike sa janë të evidentuara në territorin e Komunës sonë. Jemi duke vazhduar në asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave nëpër lagje.

Siç keni vërejtur edhe ju, kemi filluar me realizimin e disa projekteve të mëdha infrastrukturore në qytet, siç është hapja e rrugës së re pranë lumit Llap, në pjesën kah xhamia e qytetit, e cila do të shërbejë si unazë e brendshme dhe do të lehtësojë

qarkullimin e automjeteve në qytet, që do të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e asaj pjese të qytetit.

Së shpejti do të fillojmë edhe me zgjerimin e një segmenti të rrugës “Zahir Pajaziti” duke filluar nga udhëkryqi i rrugës ‘19 Qershori’ deri te udhëkryqi që lidh magjistralen Podujevë-Prishtinë, ku paralelisht do të bëhet edhe rregullimi i infrastrukturës përcjellëse.

Ndërtimin e infrastrukturës rrugore jemi duke e përcjellë edhe me shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në të gjitha lagjet e qytetit, por edhe në disa fshatra.

Gjithashtu jemi në fazën e përmbylljes së ndërtimit të rrjetit të kanalizimit dhe kemi filluar me ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në mbrojtjen e ambientit sepse ujërat e zeza do të largohen nga lumenjtë.

Gjithashtu vlen të përmendet se tashmë ka filluar funksionalizimi i Spitalit të Qytetit, ku fillimisht është duke ofruar shërbime Reparti i Maternitetit. Besojmë se së shpejti, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, do t’i funksionalizojmë edhe repartet e tjera të spitalit.

Ka edhe shumë projekte të tjera që janë duke u realizuar dhe që pritet të realizohen gjatë këtij viti në sektorë të tjerë. Por, për të gjitha këto qytetarë të nderuar, më gjerësisht do të ju informojnë vetë drejtorët e drejtorive përkatëse.

Pas prezantimeve nga ana e drejtorëve, do të marrim vlerësimet e juaja, por edhe do të japim përgjigje lidhur me çështjet që ju shprehni interesim, për të sqaruar ose për të komentuar. Fillimisht fjalën e ka z. Faik Muçiqi Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSH; theksoi, ju informoj për ecurinë e realizimit të projekteve në fushëveprimin e DSHPMSH për periudhën në gjashtë mujorin e parë 2018. Drejtoria e SHPMSH për këtë vit ka një buxhet prej 1, 87500 €, deri më tani pagesa janë realizuar në shumë 770,000 €, afër 40%. Drejtori foli për projektet e kanalizimeve dhe kolektorëve, projektin e trotuareve, ndriçimin, pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve, rrugët me zhavorr, etj. për gjendjen aktuale dhe për planin dinamik të realizimit të tyre, koston financiare, si dhe për lokacionet apo vendet ku janë duke u realizuar projektet. Nënvizoi, një falënderim të veçantë kam për qytetarët të cilët kanë mirëkuptim për shkak të dëmtimit të pronave të tyre gjatë realizimit të projekteve, për shkak të natyrës së punimeve dhe që fatkeqësisht nuk po ka mundësi t’u kompensohet dëmi për shkak të problemeve të natyrës ligjore.

z.Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit; theksoi, pasi që Drejtori i DPUMM nuk është sot prezent në këtë takim për shkak të punëve dhe angazhimeve që ka, në vend të tij do të ju informoj për rrjedhën e realizimit të projekteve brenda kësaj periudhe nga fushëveprimi i kësaj Drejtorie. Buxheti për investime kapitale në kuadër të planifikimit urban është 3,061562 € . Drejtori i informoi për projektet të cilat kanë qenë nga viti i kaluar, si projekte dyvjeçare dhe për fazat e realizimit të tyre, për projektet që kanë filluar dhe që janë në proces të realizimit si dhe për projektet në kuadër të procedurave të prokurimit.

Drejtori gjithashtu informoi të pranishmit edhe për punën dhe projektet nga fushëveprimi i Drejtorisë së Inspeksionit. Ndër tjera theksoi, kemi filluar me lirimin e hapësirave publike me ç’rast i falënderoj të gjithë shitësit ambulant te të cilët kemi hasur në mirëkuptim dhe jemi të kënaqur me opinionin e qytetarëve.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, e hap diskutimin.

Konstatim:

Lidhur me temën, përkatësisht rreth projekteve dhe punëve të prezantuara nga Drejtorët e Drejtorive, në diskutim morën pjesë një numër i konsideruar i qytetarëve

dhe përfaqësuesve të fshatrave të cilët falënderuan Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive përkatëse për punën në përgjithësi por edhe për projektet brenda periudhës raportuese. Njëkohësisht shtruan edhe shumë kërkesa për projekte të ndryshme në fshatra dhe rajone përkatëse.

z.Burim Cakaj, përfaqësues i fshatit Llapashticë e Epërme; shtroi kërkesën për rregullimin e një rruge në gjatësi rreth 600 m. Theksoi, projekti për rrugën është hartuar në vitin 2013, nuk jemi në dijeni për arsyen e shtyrjes së realizimit të tij.

z.Nexhat Llallosi, banor nga fshati Herticë; shtroi kërkesën për rregullimin e rrugës nga lagja e Llallosëve deri te lagja e Mulla Idrizit.

z.Bajram Vokrri, përfaqësues i fshatit Sfeçël; shtroi kërkesën për pastrimin e shtratit të lumit që kalon nëpër fshatin Sfeçël, si dhe kërkesën për asfaltimin e rrugës Sfeçël – Surkish.

z.Milaim Gashi, banor nga fshati Dobërdol; theksoi, falënderojmë Kryetarin e Komunës për punën dhe investimet e bëra në fshatin e Dobërdolit.

z.Ramush Jupolli, përfaqësues i fshatit Shajkoc; theksoi, në fshatin Shajkoc është punuar shumë megjithatë kanë mbetur disa rrugë në disa lagje të fshatit që ka shumë nevojë për rregullimin e tyre, vlen të theksohet lagja Sinani.

z.Osman Bahtiri, përfaqësues i fshatit Gllamnik; theksoi, në fshat është punuar bukur shumë, mirëpo fshati ka një shtrirje të gjerë kështu që ka nevojë ende për investime në infrastrukturë në rrugica dhe kanalizime, trotuare në rrugën magjistrale ku është më se e nevojshme te lagja e Arbanashëve dhe Kosumajve për shkak të gravitimit të nxënësve, po ashtu ka nevojë edhe për rregullimin e një rruge që lidhë fshatin Gllamnik me fshatin Siboc e që lidhet me fshatrat Sfeçël dhe Dumosh, pastaj për ndërtimin e një ure në rrugën që lidhë fshatin Gllamnik me fshatin Kunushec, pastrimin dhe zgjerimin e përrorskës, si dhe për ndërtimin e një salle të edukatës fizike. Si përfundim çështje problematike theksoi atë të mbeturinave në fshat.

z.Hetem Ajeti, theksoi, ne banorët e fshatit Sfeçël i jemi mirënjohës Kryetarit të Komunës për punët që janë realizuar, mirëpo kam vërejtje në fushën e shëndetësisë, për shkak të mosrespektimit të orarit nga ana e stafit shëndetësorë të ambulantes në fshat. Si kërkesë kam ti bëhet ndriçimi shtatores së dëshmorit Ali Ajeti,.

z.Fadil Berisha, përfaqësues i fshatit Kunushec, theksoi, kam disa kërkesa duke filluar nga një pjesë e kanalizimit e cila ka mbet pa u përfunduar dhe asfaltim të rrugëve në disa lagje, pastaj shtruarja me zhavorr e rrugëve, për shkak se në këtë gjendje nuk kemi mundësi t'i shfrytëzojmë ato livadhe e kullota. Si përfundim shtoi kemi nevojë për një ambulancë që do të shërbejë për tri fshatrat Kunushec Buricë dhe Penuhë.

z.Isuf Gashi, përfaqësues i fshatit Dobërdol, uroj për punët e kryera. Sa i përket kërkesave për fshatin Dobërdol ato i kemi bërë në formë të shkruar në Drejtoritë përkatëse për periudhën 2019-2021. Theksoi, është mirë që të kemi një pasqyrë të punëve dhe projekteve me afatet kohore se kur do të realizohen.

z.Shaban Menxhiqi, përfaqësues i fshatit Lupç i Epërm; theksoi, kam një kërkesë për rregullimin e një rrugë rreth 1 km, e cila lidhë afër 30 ha tokë bujqësore, ku të vjelat dhe punimi i tokës bëhet përmes asaj rruge, s'paku të zgjerohet dhe të shtrohet në zhavorr.

z.Ruzhdi Fazliu, përfaqësues i fshatit Dumnicë e Epërme; theksoi, kam disa kërkesa, dhe atë: Për ndërtimin i shkollës, asfaltimin e disa rrugëve të fshatit, rregullimin e një rruge me zhavorr dhe zgjerimin e shtratit të lumit.

z.Nuhi Selimi, përfaqësues i fshatit Orllan; theksoi, kërkesa të mëhershme dhe të vazhdueshme kemi pasur për ujin e pijes dhe kanalizimin, por si duket fatmirësisht këto janë në proces të realizimit duke ju falënderuar Kryetarit të Komunës. Si kërkesë

për komunitetin kam rregullimin e një trotuari në drejtim të urës në Orllan, sepse paraqet rrezik për këmbësor sidomos për fëmijë, pra duhet bërë një zgjidhje. Përndryshe kërkesat për investime në fshatin Orllan i kemi dorëzuar në formë të shkruar në Drejtoritë përkatëse.

z.Fadil Gërguri, banor i fshatit Siboc i Poshtëm; theksoi, një projekt i kanalizimit ka dështuar për shkak jo të Komunës por të fshatarëve, njëri prej banorëve ka penguar realizimin e projektit, pyetja është se a mund ti bëhet zgjidhje këtij problem. Kërkesë kemi për asfaltimin e një rrugë e cila na lidhë me fshatin Kaqybeg, në gjatësi rreth 300 m. Problem të theksuar kemi çështjen e ambientit si shkak i hedhjes së mbeturinave, problem i cili po përsëritet në fshat, veçanërisht rreth shkollë. Kërkoj nga Drejtoria përkatëse që ai vend të mbushet me dhe, ndërsa ne si komunitet pastaj do ta pyllëzojmë atë vend.

z.Fehmi Bajraktari, përfaqësues i fshatit Batllavë; theksoi, kemi kërkesë për asfaltimin e disa rrugëve. Sa i përket kanalizimit fatmirësisht një ka filluar por kërkoj që autoriteti komunal të jetë më prezentë gjatë procesit të realizimit të projekteve. Kërkesë tjetër është për rregullimin e oborrit të shkollës së fshatit, për ta siguruar nga depërtimi i ujit si rezultat i vërshimeve. Rreth kanalizimeve kemi vërejtje për shkak se nuk ka mundësi të derdhen në kolektorin kryesor, çfarë mund të bëhet në këtë rast.

z.Vehbi Podvorica, përfaqësues i fshatit Dumosh; shtroi kërkesë për asfaltimin e një rrugë që lidhë fshatin Dumosh me fshatrat Sfeçël dhe Gllamnik, një trotuar dhe kanalizim për dy shtëpi pran aeroportit.

z.Naim Llalloshi, banor i qytetit; theksoi, kemi një kërkesë për rrugën “ Bekim Lushaku”, për shkak të vozitjes së shpejtë të automjeteve, të ndërmerret diçka në këtë drejtim, pasi që në atë aks rrugor ka pas raste të aksidenteve me fatalitet. Kërkesa tjetër është që në kuadër të mundësive të na lejohet shitja e syzave në hapësirat publike pasi që në lokacione tjera nuk ka mundësi të zhvillohet kjo veprimtari. Këtë e kam të vetmin burim jetese, andaj kërkoj që të na bëhet një zgjidhje.

z.Fadil Ademi, përfaqësues i fshatit Pollatë; theksoi, kam disa kërkesa për fshatin Pollatë. Disa prej tyre i kemi përsëritur. Nëpër fshat kalojnë dy lumenj dhe kemi nevojë për disa ura, pastaj rrjet të kanalizimit për një lagje, ndërtimin e trotuarit dhe të hartohet një plan për rregullim të ambientit rreth shkollës.

z.Fatmir Thaçi, fshati Zakut; theksoi, kërkesat për projektet dhe nevojat që ka fshati Zakut i kemi parashtruar në Drejtoritë përkatëse në formë të shkruar dhe kërkojmë të njoftohemi lidhur me kërkesat.

z.Rexhep Dauti, përfaqësues i fshatit Llaushë; theksoi, kërkesat e banorëve të fshatit janë:

Asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Llaushë – Dobërdol në gjatësi 2500 m; Ndërtimi i rrugës (së paku me zhavorr) për dy familje në pjesën kufitare; Asfaltimi i rrugës për lidhjen e dy shkollave në gjatësi 600 m.

z.Fitim Bunjaku, përfaqësues i fshatit Sallabajë; theksoi, kam tri kërkesa për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe atë: Vendosjen e disa pengesave në rrugët e fshatit për shkak të vozitjes së shpejtë të automjeteve; riparimi i rrugës së dëmtuar (e prerë) pas vendosjes së kanalizimit; kërkesë për renovimin e rrugës për në fshatin Shakovicë e cila është dëmtuar, është e nevojshme të intervenohet.

z.Murat Bajrami, fshati Barainë; shtroi kërkesë për rregullimin rrugëve për tri lagje të fshatit Barainë, të cilat siç theksoi janë bërë pothuajse të pakalueshme.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, pasi që nuk ka të tjerë të interesuar për të marrë fjalën, e përmbylim takimin dhe ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje për sugjerimet dhe kërkesat e paraqitura. Ne paraqitëm realizimin projekteve dhe

planifikimet gjatë këtij viti. Sigurisht se do të arrijmë që edhe në fazën e dytë të përmbyllim projektet sipas planifikimeve. Meqë jemi në fazën e hartimit të buxhetit të Komunës për vitin e ardhshëm i kemi parasysh këto kërkesa edhe shumë të tjera të cilat do të merren për bazë në raport me mundësitë buxhetore që kemi.

Mbledhja përfundoi në orën 11.50

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/06-0060076/18
Podujevë, 27.06.2018**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**